

**RAPORT**  
**I**  
**VEPRIMTARISE SE**  
**DREJTORISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM NE METE,**  
**PER PERIUDHEN E VITIT 2006.**

Drejtoria e Auditimit te Brendshem ( DAB ) eshte pjese e struktures dhe organikes se Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes. Ndonese, sfera e veprimtarise se saj , per nje vit eshte teper e gjere dhe komplekse, ne kete raport jemi perpjekur ta pasqyrojme ate nepermjet trajtimit te disa drejtimeve kryesore, si me poshte :

***I. Organizimi, perberja dhe funksionimi i strukturave te auditimit.***

Mbeshtetur ne Urdherin e Kryeministrit nr .187, date 23.11.2005 “Per miratimin e struktures dhe organikes se Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes”, struktura e Drejtorise se Auditimit te Brendshem eshte miratuar me 3 sektore me numrin total ne organike prej 10 veta

Varesia e struktures se auditimit eshte nga Titullari i Ministrise. Niveli profesional i auditeve te brendshem eshte i mire. 5 inpektore jane te certifikuar me titullin “ Audit i perkohshem ne sektorin publik “. Gati 50 % e tyre kane ndjekur dhe fituar provimin per certifikimin ne “ Audit i brendshem ne sektorin publik “. **Te gjithë kane nje eksperience pune mbi 18 vjet dhe kane nga 5 vjete deri ne 15 vjet ne strukturat e auditimit financiar.**

***II. Drejtimet kryesore te veprimtarise audituese dhe rezultatet e zbulimeve te saj.***

**a.** Bazuar ne gjendjen dhe problematiken e zbuluar gjate procesit te auditimit, Drejtoria e A.B, ka : bere vleresimet perkatese, percaktuar pergjegjesite individuale ne entitetet ku eshte ushtruar auditim, pergatitur dhe derguar rekomandimet e saj.

**Ne mbeshtetje te detyres ligjore dhe funksionale te struktures sone, per te gjitha rezultatet e auditimeve te kryera eshte informuar Titullari i Institucionit.**

***b.Hartimi dhe realizimi i programeve te auditit.***

Ne zbatim te kerkesave te nenit 6 te Ligjit 9009, date 13.02.2003 “ Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik “ dhe te paragrafit te dyte te pikes 8 te Seksionit II te VKM nr 345, date 1.06.2004 “ Per miratimin e manualit te procedurave te auditimit te brendshem ...” auditimi i ushtruar ka synuar te perfshije ato objektiva qe paraqesin rendesi dhe perbejne detyren me kryesore te kerkuar me ligj. Veprimtaria audituese eshte orientuar ne : **kontrollet e brendeshme, financiare dhe te drejtimit.**

***Ne mbeshtetje te Programit te Qeverise 2005-2009 e cila ka shpallur si prioritet absolut luften per cmontimin dhe shembjen e strukturave te sistemit te korrupsionit, dhe DAB si objekt te punes se saj ka patur si drejtim themelor, ate te parandalimit dhe te ndeshkimit te korrupsionit.***

Sipas Planit Vjetor te Auditimit te vitit 2006 (miratuar me shkresen nr. 3149 prot, date 5.11.2005 ) dhe ne mbeshtetje te shkreses nr.5781 prot, date 26.07.2006 “ Rishikim i planit te auditimeve te vitit 2006 “ te miratuar nga Ministri , **jane parashikuar te kryhen per vitin 2006, 63 auditime, gati ne 39 % te entiteteve publike te varesi te drejteperdrejte te METE, duke marre ne konsiderate dhe frekuencen e auditimit.**

Per periudhen e vitit 2006,auditimet e realizuara, sipas natyres dhe permbajtjes se tyre, grupohen :

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Programuar</b>	<b>Realizuar</b>
1.	Auditime mbi rregullshmerine dhe ligjeshmerine.	52	38
2.	Auditime vleresuese e tematike.	11	22
3.	Verifikime e te tjera.	-	3
	<b>Totali</b>	<b>63</b>	<b>63</b>

Analitikisht emertesa e auditimeve te kryera prane entiteteve te varesise se METE-s, paraqitet ne Pasqyren nr 6.

Sipas fushave dhe drejtimeve, auditimi i ushtruar ka synuar te perfshije ato objektiva qe paraqesin rendesi dhe perbejne detyren kryesore te kerkuar me ligj.

Subjekt auditimi kane qene : Subjektet e varesise se drejteperdrejte (Shoqerite anonime, Shoqerite me Pergjegjesi te Kufizuar, Shoqerite ne likujdim, Institucionet qendrore me vetefinancim, etj ).

Subjektet e perfshira ne auditim ( per auditimet e perfunduara ) ne numer sipas natyres se tyre, renditen si me poshte :

- **19 auditime ne Shoqerite anonime.**
- **2 auditim ne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar.**
- **10 auditime ne njesite ekonomike ne likujdim.**
- **32 auditime ne entitete me status te ndryshem.**

**Gjithsej 63 auditime**

Kapacitet audituese ne raport me detyrimin per auditim, nuk kane qene te plotesuara. Nga perlllogaritjet e ngarkeses per cdo auditim, kane rezultuar mesatarisht **per rreth 8 objekte te audituar per person .**

Nga totali i auditimeve te realizuara (63 ), **vetem 33 auditime ose 52 % e tyre kane qene te programuara per periudhen e vitit 2006.** *Arsyeja e ketij fakti lidhet me :*

• **Angazhimin, ndjekjen dhe zbatimin e tematikave te iniciuara nga Titullari per verifikimin e problematikave, kerkesave ,apo ceshtjeve per te cilat kerkohej auditim .**

Jane kryer 30 auditime te drejtimit ( tematike ), ne entitetet e listuara ne Tabelen nr 7.

• **III. Zbulimet e shkeljet ligjore dhe demet e shkaktuara.**

Gjate auditimeve jane zbuluar dhe evidentuar te meta, mangesi dhe dukuri negative me pasoja ekonomike ne dem te pasurise publike.

*Me konkretisht :*

▪ **Vlera e pergjithshme e zbulimeve nga auditimet per kete periudhe rezulton ne shumen 681.872 mije leke, ose e ndare sipas strukturave paraqitet :**

❖ **Nga struktura e auditit prane Ministrise ne shumen 617.866 mije leke.**

❖ **Nga struktura e auditit ne subjektet e varesise ne shumen 64.006 mije leke.**

Nga totali :

**a). Mungesa e demtime,**

▪ **Rubrika B.1 Percaktuar Pergjegjesia, per 164 persona, gjithsej 489.147 mije leke, kerkuar per zhdemtim shuma 488.972 mije leke, ose e ndare sipas strukturave paraqitet :**

▪ **Nga struktura e auditit prane Ministrise, per 73 persona ne shumen 480.115 mije leke.**

▪ **Nga struktura e auditit ne subjektet e varesise , per 91 persona ne shumen 9.032 mije leke.**

**b). Shkelje te disiplines financiare**

**Rubrika C.1 Percaktuar Pergjegjesia, per 1297 persona, ne shumen 178.615 mije leke e gjitha, kerkuar per zhdemtim,ose e ndare sipas strukturave paraqitet :**

▪ **Nga struktura e auditit prane Ministrise, per 105 persona ne shumen 136.926 mije leke.**

▪ **Nga struktura e auditit ne subjektet e varesise , per 1192 persona ne shumen 41.689 mije leke.**

**c). Shkeljet pa dem ekonomik, te ndara sipas rubrikave paraqiten :**

**A. Te disiplines financiare ne shumen 25.876 mije leke, nga te cilat nga struktura e METE, ne 269 raste ne shumen 2.335 mije leke.**

**B. Te procedurave ligjore ne shumen 30.185 mije leke, nga te cilat nga struktura e METE, ne 493 raste ne shumen 8.295 mije leke.**

( Me hollesisht te dhenat jepen ne Pasquren nr 3. bashkelidhur )

Referuar shumes totale te zbulimeve te kryera nga struktura e organit qendror, prej 617.866 mije leke, bejme prezent faktin se :

• **Masa e zbulimeve ne vitin 2006 eshte gati 3.8 here me shume se ne vitin 2005.**( Zbulimet gjithsej ne vitin 2005, jane 161.461 mije leke )

- Zbulimet me te medha, **gati 82 % ndaj totalit ,jane evidentuar prane Zonave Elektrike te Shperndarjes ne rrethet Tirane, Shkoder, Fier dhe Sarande.**

***Per te gjitha te metat, mangesite dhe shkeljet e disipline financiare te konstatuara, nga auditet e DAB, jane dhene gjithsej, 442 rekomandime dhe propozime, te ndara si vijon :***

- **Per permiresimin e sistemeve te organizimit te kontrollit te brendshem jane dhene 261 rekomandime.**
  - **Per 99 persona jane rekomanduar masa disiplinore.**
  - **per 34 persona jane rekomanduar gjoba ne shumen 2.389 mije leke.**
  - **Ne 39 raste, per 72 persona jane rekomanduar masa zhdemtimit ne shumen 9.704 mije leke.**
  - **Ne 9 raste, per 62 persona jane derguar informacionet perkatese prane Prokurorise se Rrethit Gjyqsor , per referimin e vepres penale ndaj tyre.**

Masat e rekomanduara jane lidhur kryesisht me percaktimin e rrugeve dhe drejtimeve qe mundesojne mbylljen e shtigjeve per veprime te kunderligjshme dhe abuzive per fondet publike. Keto masa jane kryesisht te karakterit ligjor, organizativ dhe kur ka vend edhe disiplinor, te zhdemtimit, administrativ.

#### ***IV. Masa disiplinore dhe administrative per shkeljet dhe demet e shkaktuara.***

Per periudhen raportuese jane rekomanduar :

▪ **269 masa disiplinore,** ose e ndare sipas strukturave paraqitet :

❖ **Nga struktura e auditit prane Ministrise, jane rekomanduar 168 masa disiplinore.**

Llojet e tyre, sipas entiteteve paraqiten ne pasqyren nr 4.

- Per 259 persona, gjoba ne **shumen totale 9.373 mije leke.**
- Per 34 persona, per shkelje te neneve 248,186 dhe 258 te “ Kodit Penal te Republikes se Shiperise “ jane bere 9 denoncime per ndjekje penale.

Nga organi qendror ( METE ), jane bere **9 denoncimet, per 62** persona, prane Prokurorise se rretheve Shkoder,Tirane, Sarande dhe Fier.

Gjate ushtrimit te auditimeve eshte punuar per nxjerrjen e percaktimin e pergjegjesive per demet dhe shkeljet e vertetuara. Rastet e konstatuara jane evidentuar e pasqyruar ne materialet e kontrollit.



